



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 90

Prishtinë, më 16.09.2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala 2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, kryetar, Behar Selimi, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Halit Krasniqi, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Gëzim Kelmendi dhe Sreten Ivanoviq.

Munguan: Haki Demolli dhe Mufera Shinik.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Enver Peci- kryesues i KGJK-së, Albert Avdiu – KGJK, Delfinë Elshani- Grupi për Studime Juridike, Lumnije Murati – ZPRK, Lejla Selimi – OSBE, Artan Canhasi dhe Vlora Marmullakaj-EULEX, Ardian Bajraktari – MD, Avni Tusha dhe Imba Rudaku– praktikantë.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 1 dhe 8.7. 2013;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, natyrës, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 1 dhe 8.7. 2013

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 1. dhe 8.7. 2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012

Kryetari, ftoi Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor që ta prezantojë raportin vjetor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012.

Enver Peci – Në fjalën e tij, tha se ne kemi pasur vazhdimisht dilema se a duhet që Këshilli Gjyqësor i Kosovës t'i raportojë këtij komisioni.

Megjithatë, prapë po them për hir të respektit, në aspektin e Kushtetutës, duhet të tregoj se jemi institucion i themeluar prej Kuvendit dhe nuk jemi agjenci e pavarur, mirëpo janë disa dilema që ne si Këshill Gjyqësor i Kosovës po i kemi. Në kuptimin kushtetues, KGJK-ja është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij. Në nenin 108, pika 8, thuhet: “kryesuesi i KGJK-së i drejtohet Kuvendit të Republikës së Kosovës së paku njëherë në vit lidhur me sistemin gjyqësor”. Domethënë t'u drejtohet të gjithë deputetëve. Megjithatë, nëse ju parashihni që unë gjithsesi duhet të raportoj, atëherë në pika të shkurta do të raportoj dhe do t'i them disa fjalë, edhe pse e keni marrë me shkrim me kohë. Jemi munduar të bëjmë një raport pak më të gjerë, sesa vitin e kaluar, me disa fiksime pak më të gjata për të gjitha aktivitetet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Me të vërtetë, viti i kaluar ka qenë vit i sfidave për sistemin gjyqësor në përgjithësi, për shkak se ka qenë Ligji për gjykatat. Po ashtu, në raport përmenden edhe aktivitetet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës që i ka pasur gjatë vitit. Fillimisht, me planin e implementimit të Ligjit për gjykata, ka filluar të formohet edhe komisioni i KGJK-së, me grupet dhe nëngrupet, si: grupi i punues në ofrimin e asistencës teknike, nëngrupi punues i logjistikës, nëngrupi punues i burimeve njerëzore, nëngrupi punues i administratës, nëngrupi punues për publikimet etj.

Vlen të theksohet se përkundër të gjitha sfidave dhe vështirësive, kemi arritur të startojmë me punën tonë, ashtu siç ka paraparë Ligji për gjykatat, më 1 janar 2012. Gjatë vitit 2012, Këshilli ka arritur të nxjerrë akte të brendshme, rregullore për vlerësimin e performancës së gjykatësve, rregulloren mbi organizimin dhe veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, rregulloren mbi organizimin e brendshëm të gjykatave, rregulloren për procedurën e rekrutimit të praktikantëve në gjykata, udhëzimin administrativ për procedurën e lëmit të personave të dënuar, kodin e etikës për anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Sa i përket procesit të emërimit të gjyqtarëve, po ashtu, ka filluar gjatë vitit 2012. Nga ky proces, janë emëruar 55 gjyqtarë në gjykatat komunale dhe 41 gjyqtarë në gjykatat për kundërvajtje. KGJK-ja, gjatë vitit 2012, ka punuar edhe në procesin e integriteteve evropiane, në udhërrëfyesin e liberalizimit të vizave dhe studimin e fizibilitetit për marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Evropian. Disa nga kërkesat kemi arritur t'i plotësojmë, mirëpo ka ende për t'u bërë.

Kryetari – Duke u ndërlidhur me parafolësin, tha se është e vërtetë që KGJK-ja ka pasur dilemë në raportimin ose jo të KGJK-së në komision. Po ashtu, është e vërtetë se çka ndodh në rast se raportet e agjencive të pavarura që i raportojnë Kuvendit, nuk kalojnë në seancë. Kjo është një dilemë e pazgjidhur ende dhe besoj se duhet gjetur zgjidhje. Komisioni është trup i Kuvendit dhe shtrohet dilema se a duhet që t'i drejtohet Kuvendit në seancë apo në komision. Mund të ketë hapësirë për

interpretim. Ne kur të rekomandojmë për seancë raportin, nëse jo, ne mund të rekomandojmë që edhe ju t'i drejtoheni seancës. Mendoj se mund të përdoren edhe praktika të tilla dhe mund të kenë efekte pozitive, që problemet të cilat ekzistojnë në sistemin e drejtësisë në Kosovë, të diskutohen haptazi me deputetë dhe pastaj të merren vendime. Problemi është pastaj se sa mund të shkohet deri te politizimi, dhe të ruhet mosndërhyrja në raste të caktuara, që të mos politizohen ato. Mendoj se Kuvendi duhet të ndërtojë një rrugë të mirë të raportimeve dhe besoj se po aq sa është i vërtetë parimi i barazisë së pushteteve, po aq eksiton edhe parimi i ndërvlerësive së pushteteve. Pushtetet janë të pavarura, aq sa janë të ndërvleruara dhe koncepti i pavarësisë absolute besoj që nuk ekziston. Nuk ka pavarësi absolute, sepse në fund të fundit ne jemi të zgjedhur nga qytetarët dhe ne kemi vendosur se si duhet të organizohet dhe funksionojë Kuvendi, dhe ajo pastaj është shkruar në Kushtetutë, e pastaj ju duhet t'i raportoni themeluesit, që ne t'i raportojmë popullit. Besoj se në këtë ka logjikë dhe me këtë logjikë, besoj se ju duhet t'i raportoni Kuvendit.

Arsim Bajrami – Mendoj se ne sot duhet të zgjedhim çështjen parimore, të cilën e shtroi edhe kryetari i KGJK-së, pra për korrektësinë që ka pasur deri më tani dhe ka ardhur rregullisht në thirrjet që i ka bërë komisioni. Mendoj se ne duhet të bëjmë një zgjidhje se kujt duhet t'i raportojë, Kuvendit apo Komisionit. Kjo është një çështje kushtetuese që duhet ta zgjidhim se deri ku mund të shkojë debati parlamentar për çështjet e gjyqësisë. Unë nuk e mohoj të drejtën e parlamentit për t'u marrë me segmente të gjyqësisë, por është një kufi se deri ku mund të shkohet, sepse mund të krijohen imazhe të këqija për Kosovën, që mund të dalin në raporte ndërkombëtare, si ndërhyrje të politikës në gjyqësor. Mendoj se ne si komision, e kemi për detyrë të definojmë se çfarë ka për detyrë Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurial, eventualisht Gjykata Kushtetuese, në raport me Kuvendin. Mendoj se kryetarëve, të Këshillit Gjyqësor, Këshillit Prokurial, Institucionit të Avokatit të Popullit, duhet t'u mundësohet raportimi në seancë dhe të informojnë për gjendjen, nevojat, objektivat e institucioneve gjegjëse. Le të marrim një qëndrim unik dhe le të rekomandojmë si komision, që të bëhet raportimi vjetor nga këto institucione në seanca, në mënyrë korrekte.

Albulena Haxhiu – Nuk do të ndalem në hollësitë e raportit ose vërejtjet, sepse kam një sërë vërejtjesh ndaj këtij raporti të përpiluar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, mirëpo do të ndalem në dy çështje që konsideroj se janë shumë të rëndësishme. E di që ky Këshill ballafaqohet me shumë probleme, si mostransparencën, pra të gjitha çështje e rëndësishme që trajtohen, janë jotransparente karshi qytetarëve. Edhe lëndët e vjetra janë shqetësim, pra numri i madh që ka mbetur nga lëndët e vjetra. Edhe mosndëshkimi i gjyqtarëve që i thyejnë rregullat, të cilët janë të detyruar që t'i respektojnë. Në fjalën hyrëse, z.Peci shprehu shqetësimin për raportimin në Komisionin për Legjislacion, duke konsideruar se ndoshta është ndërhyrje në punën e KGJK-së. Mirëpo, unë konsideroj se është plotësisht e ligjshme që ju të raportoni në këtë komision, e edhe më mirë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Dy çështjet, që për mua paraqesin shumë shqetësim, janë se ju keni marrë pjesë në bisedimet mes Kosovës dhe Serbisë. Unë konsideroj se është jashtë çdo norme kushtetuese dhe plotësisht e paligjshme, meqë kryetari i KGJK-së që është i thirrur që ta mbrojë rendin kushtetues, t'i bashkëngjitet ekzekutivit dhe të marrë pjesë në negociata të tilla. Lidhur me këtë, mendoj se duhet të japë edhe dorëheqje. Çështjet e sistemi të drejtësisë, janë tashmë të rregulluara dhe çdo tejkallim i këtyre autorizimeve është shkelje e rëndë. Çështja e dytë, ka të bëjë me heqjen e logos nga vendimet e gjyqësorit. Para marrëveshjeve, të gjitha vendimet që kanë dalë nga gjykatat e Kosovës, kanë pasur logon e Kosovës, ndërsa pas arritjes së marrëveshjeve, nuk ka pasur më në asnjë vendim gjyqësor logo të Republikës së Kosovës. Pse e keni hequr logon?

Armend Zemaj – Shprehu mendimin se është e nevojshme që komisioni ta ketë si pikë të veçantë të rendit të ditës, ta shqyrtojë dhe të debattojë, e nëse është nevoja edhe ta shohë edhe kornizën ligjore, që të gjendet zgjedhja më e mirë e mundshme rreth funksionimit të institucioneve të pavarura. Është shumë normale që frika nga ndërhyrjet politike të theksohet, sepse vetë publiku dhe ne si deputetë kemi tërhequr vërejtjen se kohë pas kohe ka ndërhyrje politike në gjyqësor, edhe pse në raport nuk

kam parë një shënim të tillë. Mendoj se duhet ta gjejmë një modul për praktikat më të mira parlamentare. Si anëtarë i këtij komisioni, propozoj që kjo temë të shtrohet në një ditë të veçantë, në nivel të veçantë, jo vetëm për KGJK-në, po edhe për të gjitha këto institucionet që i përmendëm.

Behar Selimi – Pyeti: Cili është statusi i strategjisë së re për reduktimin e lëndëve dhe cili është kriteri për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve pas tri vitesh, çfarë standardi është? A mos është tepër që të pritet tri vite, e pastaj të bëhet vlerësimi i një gjyqtari?

Enver Peci – Lidhur me pyetjet e adresuara nga deputetja Albulena Haxhiu, tha se me gjithë dëshirë do t'u përgjigjesha pyetjeve që parashtrove, por ne po debatojmë për raportin e vitit 2012. Kështu, mund të them shkurt se KGJK-ja është institucioni kryesor, sa i përket edhe integritit të strukturave paralele dhe mund ta them me plot përgjegjësi se nuk kemi qenë grup politik, por grup teknik, dhe pa ne, me të vërtetë nuk do të kishte qenë e mundur të bëhej asgjë, për shkak se nuk i kanë njohur rrethanat e gjyqësorit. Absolutisht, ne nuk kemi marrë asnjë lloj vendimi dhe as nuk kemi nënshkruar. Kjo është e tëra. Sa i përket logos, kemi shkuar me logjikën se aktgjykimet në gjykata i merr populli dhe populli është mbi të gjitha. Edhe në aktgjykimet në rajon, logot nuk përdoren. Heqja e logove është bërë pa filluar ende bisedimet nga aktgjykimet.

Sa i përket statusit të strategjisë, tregova se strategjia e vjetër ka arritur rreth 60% t'i zvogëlojë lëndët. Gjatë këtij viti, kemi aprovuar strategjinë e re. Sa i përket kriterit të vlerësimit të gjyqtarëve, mandati i fillestar i gjyqtarëve është trevjeçar dhe ka interpretime të ndryshme. Mirëpo, sipas rregullores së punës së gjyqtarëve, do të bëhet vlerësimi i të gjithë gjyqtarëve, e jo vetëm të gjyqtarëve fillestarë.

Kryetari – Pasi konstatoi se nuk ka më pyetje për kryetarin e KGJK-së, e falënderoi atë për raportimin e bërë në komision dhe se do të njoftohet për çështjet që u ngritën, lidhur me dilemat e raportimit.

Mendoj se çështja është delikate dhe se ne duhet të debatojmë pak se për çfarë do të vendosim lidhur me raportimet e institucioneve të pavarura. Pra, a duhet që këta të raportojnë në komision, e pastaj të dërgohet në seancë, a duhet të raportojnë në seancë me debat apo pa debat dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me raportime të tilla. Duhet të gjendet një model praktik se si do të veprohet, të marrim edhe shembuj nga rajoni e të shohim si realizohet komunikimi mes agjencive të ngjashme dhe kuvendeve përkatëse. Pra, të bëjmë një analizë krahasimtare. Nëse ne arrijmë të ndërtojmë një standard të mirë, atëherë mendoj se kemi bërë një punë të mirë si komision.

Armend Zemaj – Mendoj se do të ishte mirë që komisioni të organizojë një tryezë të përbashkët me këto institucione dhe të vinim deri të zgjedhja më e mirë e mundshme. Kështu edhe do të mund të ikim presioneve se po bëjmë ndërhyrje në gjyqësor, dhe ta avancojmë këtë mënyrë të raportimit. Besoj që mund të arrijmë rezultate të mira

Arsim Bajrami – Këto institucione që janë specifike dhe kanë rol të rëndësishëm shtetëror, e shoh shumë të nevojshëm të ndërtojmë një standard në raportimet e tyre, si dhe të gjejmë mënyrën se në çfarë forme do të raportojnë dhe sa do të lejohet debati në raportime të tilla. Propozoj që këtë raport të mos ia përcjellim Kuvendit për shqyrtim, derisa mos të gjejmë një zgjidhje rreth raportimit të tyre në seancë.

Albulena Haxhiu – Po më duket pak qesharak për të diskutuar për ndërhyrjet politike në gjyqësor, përderisa po e shohim se pushteti ka futur duart në të gjitha nivelet e jetës në Kosovë. Shqetësimi im është se çfarë do të bëhet me këto raportime në seancat plenare. Ju e dini se kemi pasur raste kur raportet nuk janë miratuar në seancë dhe pastaj asgjë nuk ka ndodhur me kryesuesit apo bordin e agjencive përkatëse. Pra, të shikojmë se si ta fuqizojmë raportimin në Kuvend.

Pas diskutimeve të bëra, kryetari theksoi se është e nevojshme që të konsultohet me ekspertët e fushës dhe të bëjë një analizë krahasimtare, të shohim se si rregullohen këto çështje në vendet e rajonit dhe në BE, dhe brenda 2-3 javësh, të sjellë një raport para Komisionit.

Lidhur me këtë, u pajtuan anëtarët e Komisionit.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht

Komisioni e shqyrtoi në parim Projektligjin për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht dhe vlerësoi se projektligji ka bazë kushtetuese. Në aspektin përmbajtësor, i plotëson kushtet e përcaktuara me rregullat e hartimit të legjislacionit, si dhe kushtet e caktuara me Rregulloren e Kuvendit, për t'u proceduar për shqyrtim dhe për miratim në parim, prandaj vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, natyrës, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit

Kryetari – Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-214, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, natyrës, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit, si dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari Konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, natyrës, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 13:10.

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi